



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit të Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

“Univerzum Audit” Sh.p.k. ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit, në konsultim me menaxherin e kontratës Muje Gashi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga “Univerzum Audit” Sh.p.k. nga Besa Berisha, Udhëheqëse e ekipit si dhe Qerim Qerimi, Laura Berisha dhe Eglantina Nikqi, anëtarë.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	16
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	20
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	24
Shtojca II: Letër Konfirmimi	26

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 19.11.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Hanit të Elezit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se gjendja e investimeve kapitale të shpalosura në pasqyrat financiare vjetore në vlerë prej 1,091,818€ nuk përputhet me vlerën financiare të pasurive jofinanciare në regjistrin e asetëve për diferencën prej 663,825€.

Po ashtu asetet kapitale janë të mbivlerësuara për vlerën prej 32,305€, duke u nënvlersuar asetet nën 1000€ (e-pasuria) si rezultat i keqklasifikimit.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018**

Kryetari i Komunës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës, gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinion i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

- Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se gjendja e investimeve kapitale të shpalosura në Raportin Vjetor Financiar të Komunës, janë në vlerë prej 1,091,818€. Asetet e regjistruara në regjistrin e investimeve kapitale të Komunës janë në vlerë prej 1,842,193€ duke i përfshi edhe asetet ekzistuese të regjistruara me komision gjatë vitit 2018 në vlerë prej 1,414,200€. Investimet kapitale të realizuara gjatë vitit 2018 dhe të pa regjistruara në regjistrin e aseteve janë në vlerë prej 663,825€.

Opinion i jonë nuk është i modifikuar për këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;

-
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
 - Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
 - Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
 - Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).
 - Nëse PFV janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MF;
 - Nëse Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar me kohë; dhe
 - Nëse Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe një kopje tek MF.

Përveç çështjeve të ngritura te opinionit i auditimit përkatësisht Theksimi i çështjes, PVF-të janë përgatitur në pajtueshmëri me formatin për raportim, si dhe janë nënshkruar dhe dorëzuar brenda afatit ligjor në MF.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur, përveç atyre të përshkruara tek theksimi i çështjes.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjen e sipër përmendur jepet rekomandimi:

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për ti përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në shpalosjen e pasurive, regjistrimin e pasurive, dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të tyre

Gjithashtu Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Hanit të Elezit ka realizuar rreth 92% të të hyrave të parashikuara nga buxheti final për vitin 2018 dhe po ashtu ka shpenzuar 92% të buxhetit final për vitin 2018, që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për ti deshifruar vlerat e sakta të llogarive të arkëtueshme duke i përfshi edhe salldot e bartura dhe për të reaguar në inkasimin e tyre në masë të madhe. Gjithashtu, kontrollet kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë menaxhimi i pasurive kapitale, rritja e inkasimit të të hyrave përfshire menaxhimin e pronave komunale .

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Fina ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	2,948,263	3,097,376	2,861,153	2,422,548	2,189,897
Granti i Qeverisë - Buxheti	2,457,642	2,464,499	2,463,145	2,240,415	1,851,080
Të bartura nga viti paraprak ²	181,518	181,518	138,390	31,440	106,108
Të hyrat vetjake ³	303,597	303,597	171,825	113,852	188,624
Donacionet e jashtme dhe huamarrjet	5,506	147,762	87,793	36,841	44,084

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 12% gjegjësisht për 330,631€. Kjo rritje është si rezultat i bartjes së mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2017 në vlerë prej

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetiake.

³ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

181,517€, donacionet e pashpenzuara nga viti 2017 në vlerë prej 83€, donacionet nga MAPL/DEMOS –Grant i performances komunale në vlerë prej 29,970€, donacione nga Sharrcem në vlerë prej 110,000€, donacionet nga MASHT-i në shumë prej 2,202€ si dhe mjete shtesë nga Ministria e Financave për kategorinë paga dhe mëditje në vlerë prej 6,856€.

Në vitin 2018, Komuna ka shpenzuar 92.37% të buxhetit final ose 2,861,153€, 18% më tepër krahasuar me vitin 2017 qe tregon një trend pozitiv ne realizimin e buxhetit.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	2,766,746	3,097,377	2,861,153	2,422,548	2,189,897
Pagat dhe Mëditjet	1,444,207	1,451,064	1,451,064	1,367,010	1,391,497
Mallrat dhe Shërbimet	225,312	229,656	226,206	188,215	211,387
Shërbimet komunale	44,533	44,533	44,405	49,932	48,264
Subvencionet dhe Transferet	51,104	52,795	47,659	49,801	53,158
Investimet Kapitale	1,001,590	1,319,329	1,091,819	767,590	485,591

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur janë si në vijim:

- Ndryshime ndërmjet buxhetit final dhe realizimit për kategorinë paga dhe meditje nuk ka.
- Ndryshimi ndërmjet pagesave dhe buxhetit final për mallra dhe shërbime është 3,450€, ku nga këto mjete 765€ nga granti Qeveritarë dhe shkojnë në suficit, mjetet tjera në vlerë prej 278€ janë nga të hyrat vetanake dhe barten në vitin vijues, ndërsa vlera prej 2,405€ janë mjete nga huamarrja në arsim;
- Ndryshimi ndërmjet pagesave dhe buxhetit final për shpenzime komunale është në vlerë prej 127€, ku këto mjete janë nga granti Qeveritarë dhe mbesin në suficit;
- Ndryshimi ndërmjet pagesave dhe buxhetit final për subvencionet dhe transferet është 5,136€, këto mjete janë nga të hyrat vetanake dhe barten në vitin vijues; dhe
- Ndryshimi më i theksuar ndërmjet pagesave dhe buxhetit final është te kategoria për investime kapitale i cili ndryshim është në vlerë prej 227,509€ nga të cilat 460€ janë nga granti Qeveritarë dhe mbesin suficit, pjesa tjetër në vlerë prej 169,485€ janë të hyra vetanake dhe barten në vitin vijues, një pjesë nga donacionet në vlerë prej 55,083€ që bartet në vitin vijues si dhe vlera prej 2,479€ nga huamarrja në arsim.

Arsyeja primare e mos realizimit të buxhetit të investimeve kapitale është mosrealizimi i të hyrave vetanake të planifikuara për tu shpenzuar në këtë kategori.

Çështja A1⁴- Realizimi i buxhetit

Gjetja Ndonëse në nivel të përgjithshëm realizimi i buxhetit ishte 92%, Komuna nuk ka arritur të realizoj buxhetin për të gjitha kategoritë e shpenzimeve ku posaqërisht ndryshimi më i theksuar është te kategoria e Investimeve kapitale me një realizim prej 83%.

Rreziku Planifikimi jo real dhe realizimi i pa mjaftueshëm në kategoritë përkatëse ndikon në mos arritjen e objektivave të Komunës si dhe bartjen e obligimeve nga viti aktual në vitet në vijim.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të bëjë një vlerësim gjithpërfshirës të shkaqeve të mosrealizimit të buxhetit në disa kategori të caktuara, si dhe të sigurojë një planifikim të drejtë buxhetor krahas projekteve të synuara dhe monitorim të performancës buxhetore në baza të rregullta me qëllim të realizimit të buxhetit.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Hanit të Elezit në vitin 2018 ishin në vlerë 288,496€ ose për 15,101€ më të ulëta se të hyrat e planifikuara. Realizimi i të hyrave vetjake janë për 63,303€ më të larta krahasuar me vitin 2017. Ato kanë të bëjnë me të hyrat tatimore në vlerë prej 133,801€ dhe të hyrat jo tatimore në vlerë prej 154,695€, të realizuara kryesisht nga tatimi në pronë në pjesëmarrje prej 133,801€, taksa të ndryshme, licenca dhe të hyra nga shfrytëzimi i pronës publike.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyra tatimore	112,000	112,000	133,801	79,588	104,659
Te hyra jo tatimore	191,597	191,597	154,695	145,605	147,172
Totali	303,597	303,597	288,496	225,193	251,831

⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
 Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
 Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Çështja A2- Niveli i ulët i inkasimit të të hyrave nga taksat komunale

Gjetja Të hyrat nga taksat komunale, janë e vetmja kategori e të hyrave vetiake nga e cila realizimi i inkasimit në vitin 2018 është në vlerë prej 74,395€ gjegjësisht më i ulët se viti 2017 ku realizimi ishte 76,224€. Pra nga kjo rezulton rritja e llogarive të arkëtushme të kësaj kategorie për 11,306€ nga 250,680€ në vitin 2017 në 261,986€ në vitin 2018.

Përveç një lënde ndaj një biznesi të vetëm të dërguar në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe një lënde të bartur tek përmbauesi privat për inkasim në vitin 2015 ndaj të cilave pritët të inkasohët borxhi, si dhe për klientët e tjerë ku përveç vërejtjeve të fundit dhe përkundër aktvendimeve të lëshuara ku para- shifet edhe ndërprerja e aktivitetit të biznesit, ende nuk është marrë ndonjë hap serioz drejt inkasimit apo provizionimit të borxheve. Vlen të theksohet se nga shuma totale borxheve të kategorisë së taksave komunale vetëm te 46 klient borxhi është 61,511.60€, pasiv të cilët nuk ngarkohen fare.

Rreziku Mosndërmarrja e masave ndëshkuese për të gjitha ato biznese të cilat nuk kanë shlyer obligimet, si taksa komunale, rritë rrezikun e mosinkasimit të taksave.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj dhe të merr masa të duhura që brenda një periudhe sa më të shkurtër kohore të inkasoj të gjitha të arkëtushmet . Gjithashtu duhet të shqyrtohen të gjitha opsionet e mundshme përfshirë edhe ato ligjore për të siguruar inkasimin e të hyrave të kësaj kategorie, si dhe të krijohet dhe mbahet një evidencë e qartë dhe e kompletuar me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që menaxhimi i të hyrave vetijake të jetë më efikas.

3.1.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet MF. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë më: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqesin në mes të formularëve; rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin më thesar. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 1,451,064€, ndërsa shpenzimet ishin të njëjta me vlerë prej 1,451,064€, apo shprehur në përqindje rreth 100% e buxhetit final të kësaj kategorie ekonomike. Pjesëmarrja e shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve në shpenzimet totale të komunës është 50.72%.

Rekomandim

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 229,656€. Prej tyre ishin shpenzuar 226,206€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet komunale, derivate dhe lëndë për ngrohje, shërbime kontraktuese, shpenzime të mirëmbajtës dhe riparimeve, si dhe udhëtimeve zyrtare.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 52,795€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 47,659€ apo 90% nga buxheti final. Subvencionet e dhëna kanë të bëjnë me përkrahjen financiare nga ana e komunës për fusha dhe aktivitete të ndryshme, si për klube të sportit, shoqëri kulturo artistike, bursa, sektorin e bujqësisë etj. Në këtë kategori nuk kemi hasur në probleme që do të rezultojnë me të gjetura.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 1,319,329€. Prej tyre në vitin 2018 ishin shpenzuar 1,091,819€. Ato kanë të bëjnë me ndërtesat administrative afariste, objekte shëndetësore, objekte arsimore, ndërtimi i rrugëve regjionale, rrugëve lokale, kanalizim, ujësjellës, mirëmbajtje investive, makinë etj.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Gjatë vitit 2018, komuna ka bërë një progres në aspektin e regjistrimit të pasurive në krahasim me vitin paraprak. Megjithatë edhe përkundër progresit, ende nuk është arritur që regjistri kontabël i pasurive të jetë i saktë, në vijim do të paraqiten disa çështje, të cilat komuna do duhej t'i merrte parasysh.

Çështja B 2- Menaxhim i dobët i pasurive jo financiare

Vlera e Pasurive jo kapitale-inventarëve nën 1000€ e raportuar në Raportin Vjetor Financiar është 3,847€, ndërsa e regjistruar në regjistrin e asetëve të Komunës në inventarët nën 1000€ janë 87,383€. Në kuadër të regjistrit të inventarëve nën 1000€ janë regjistruar faturat me kode ekonomike 31610 dhe 31690 të gjitha në vlerë prej 61,106€ e cila ka shkaktua mbivlerësimin e pasurive nën 1000€ dhe nënvlerësimin e pasurive kapitale për të njëjtën vlerë. Si dhe vlera prej 26,277€ janë inventar të blerë në fund të vitit 2017 të regjistruara në fillim të vitit 2018 që në total japin vlerën e asetëve të regjistruara 87,383€.

Komisioni mbi regjistrimin pasurisë mbi 1000 euro, deri me datën e raportimit financiar nuk kanë ofruar raport mbi inventarizimin e pasurisë dhe krahasimin e tyre me regjistrat e pasurisë. Po ashtu, Komuna nuk ka zhvlerësuar pasuritë jo kapitale me vlerë nën 1,000€. Sipas zyrtarëve komunal sistemi e-pasuria nuk është mjaft funksional sepse nuk mundëson përlogaritjen e zhvlerësimit, që ka rezultuar me shpalosjen jo të saktë të pasurisë në PFV

Rreziku

Keqklasifikimi i pasurive kapitale dhe jo-kapitale rezulton me një pasqyrë jo të saktë të asetëve të Komunës si dhe mos regjistrimi i plotë i pasurisë në regjistrin e pasurive të Komunës, shkakton mangësi në menaxhimin dhe raportimin e saktë të pasurisë, duke rrezikuar njëkohësisht keqpërdorimin apo humbjen e pasurive, ndërsa mos regjistrimi i pasurisë dhe mungesa e zhvlerësimit ndikon në mbivlerësimin e vlerës së pasurisë komunale.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të siguroj se procesi i regjistrimit të pasurive në regjistrin e pasurive të Komunës duhet të realizohet duke u klasifikuar saktë në kodet ekonomike përkatëse dhe pas kryerjes së këtij procesi, gjendja e pasurive duhet inventarizuar. Pas inventarizimit gjendja e konstatuar duhet të krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme të identifikohen dhe më pas të pasqyrohen në regjistrat e pasurive.

3.3 Të arkëtueshmet

Në fund të vitit 2018 të arkëtueshmet kryesisht përbëhen prej llogarive të arketueshme nga tatimi në pronë në vlerë prej 241,599€, taksa komunale nga veprimtaria e biznesit prej 264,656€, të arkëtueshme tjera nga qiraja në vlere prej 15,954€.

Çështja B3- Mungesa e mekanizmave për inkasimin e të arketueshmeve

Gjetja Përkundër faktit se Komuna ka ndërmarr masa aktive lidhur me inkasimin e llogarive të arkëtueshme, të arkëtueshmet kanë trend rritës krahasuar me vitin paraprak. Rritja e të arkëtueshmeve ndër vite paraqet jo efikasitet në mbledhjen e borxheve, sidomos borxheve të vjetra të bartura ndër vite

Rreziku Mos aplikimi i masave konkrete lidhur me inkasimin borxheve e sidomos atyre të bartura ndër vite, ka ndikuar në rritjen e tyre dhe njëkohësisht në mos realizimin e shpenzimeve të cilat ishin planifikuar të financoheshin nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të ndërmerr masa për të shqyrtuar shkaqet për dështim të inkasimeve të llogarive të arkëtueshme dhe të siguroj mekanizma efektiv për mbledhjen e tyre. Po ashtu, Kryetari duhet të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha borxhet e prapambetura dhe të inicioj proces të rivlerësimit të llogarive të arkëtueshme, ku të gjitha llogarite do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse dhe mundësive reale për inkasimin e tyre, e në raste të caktuara të bëhet provizionimi apo shlyerja e tyre në rast të kategorizimit si borxhe të këqija.

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte rreth 22,000€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna. Komuna ka shpalosur edhe detyrimet kontingjente si konteste gjyqësore me vlere prej 18,000€ ku vërehet se ka rënje të detyrimeve kontingjente krahasuar me vitin paraprak. Komuna zbaton një proces të rregullt të raportimit të obligimeve. Drejtoritë në përgjithësi janë të vetëdijshme për kërkesat e rregullores për raportim të faturave të papaguara si dhe zyrtari përgjegjës raporton me kohë në Thesar në lidhje me këto llogari.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese

dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i mangësive të qeverisjes brenda Komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial.

Një ndër elementet kyçe të një qeverisje efektive të komunës është edhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Përgjigja efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve nuk është e kënaqshme. Kjo pjesë është trajtuar më detajisht tek kapitulli 'Progresi i zbatimit të rekomandimeve'.

Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, duke iu përgjigjur shumicës së pyetjeve me note mesatare duke filluar prej 2.52 deri në 2.92. Sipas pyetësorit komuna kishte dhënë përgjigje negative në dhjetë pyetje nga gjithsej 106 sosh.

Edhe me tutje, pyetjeve që kanë të bëjnë me regjistrimin e pasurive (pyetja 70) , ishin vlerësuar me notën maksimale 3, derisa në gjatë auditimit kemi vërtetuar se regjistrat e pasurisë jo financiare nuk janë të plota. Kjo do të thotë se menaxhmenti duhet të marrë parasysh çështjet të cilat nuk kanë arritur nivelin e pritur.

Komuna ka Planin Zhvillimor Komunal 2010-2025, ka aprovuar Strategjinë për Zhvillimin Social Ekonomik 2018-2022. Edhe me tutje Komuna nuk posedon plan strategjik kundër korrupsionit.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, secili subjekti publik me buxhet 1 deri 3 milionë duhet të ketë një auditor të brendshëm.

Çështja B4- Mungesa e themelimit të NJAB-së

- Gjetja** Komuna ende nuk ka siguruar themelimit e NJAB-së. Sipas UA 23/2009 për themelimit dhe funksionimit e NJAB në sektorin publik, neni 3 pika 2.1 përcakton se subjekti publik me buxhet 1 deri 3 milionë duhet të ketë një auditor të brendshëm. Megjithëse, gjatë vitit 2017 ata kanë siguruar një auditim të brendshëm nga Ministria e financave.
- Rreziku** Mungesa e auditimit të brendshëm mund të rezultojë me vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos i identifikojë dhe reagojë me kohë ndaj parregullsive dhe dobësive të kontrollit.
- Rekomandimi B4** Kryetari duhet të siguroj përmbyshjen e kërkesës ligjore, respektivisht të rekrutoj një auditor të brendshëm. Nëse kjo kërkesë nuk mund të realizohet, atëherë shërbimi i auditimit të brendshëm, duhet të vazhdojë të kryhet nga Ministria e Financave, apo ndonjë subjekt tjetër publik. Shërbimi i auditimit, do të mbështeste menaxhmentin në vendimmarrje dhe eliminim të dobësive

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara ishin të pamjaftueshme dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja B 5- Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

Gjetja Si pasojë e kontrolleve të pamjaftueshme menaxheriale, një pjesë e konsiderueshme e buxhetit për investime kapitale nuk është shpenzuar. Llogaritë e arkëtueshme nuk ishin trajtuar në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit si dhe nuk ishte bërë regjistrimi i pasurisë e as inventarizimi i plotë i pasurisë. Menaxhmenti po ashtu nuk posedon analiza të rregullta periodike për ecuritë buxhetore.

Komuna gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe as që përgatitet ndonjë raport për menaxhimin e tyre.

Rreziku Kërkesat e pamjaftueshme të llogaridhënies dhe raportimi i cilësisë jo të duhur reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit, procesi i regjistrimit dhe inventarizimit duhet të përfshinë gjithë pasurinë komunale. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të Komunës së Hanit të Elezit ka rezultuar në 8 të gjetura dhe rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Gjithashtu raporti i auditimit ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, një rekomandim është zbatuar; tri ishin në proces dhe katër nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarr	Statusi
1	PFV 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, si dhe të merren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar regjistrimin e plotë të pasurive dhe për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve. Gjithashtu, duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Edhe në këtë vit ka pasur keqklasifikime dhe menaxhim jo të mire të pasurisë	I pa zbatuar
2	Të hyrat Çështja - Verifikimi i pronave të regjistruara	Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit të pronave dhe të siguroj se verifikimi i 1/3-tës së tyre bëhet në baza të rregullta vjetore, në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara. Rritja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore	Gjatë auditimit kemi vërejtur se është zbatuar kjo e gjetur	I zbatuar
3	Çështja 3 - Mos arkëtimi i taksës në biznes	Kryetari duhet të sigurojë se do të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme kohore të inkasoj të gjitha të arkëtueshmet e saj. Gjithashtu duhet të shqyrtohen në mënyra aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat janë realizuar.	Kemi konstatuar se edhe më tutje ky rekomandim	I pa zbatuar

			dim është i pa pa zbatuar	
4	<p>3.7 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale</p> <p>Çështja 4 - Menaxhim i dobët i pasurive jo financiar</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj që në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike, të eliminoj mangësitë në sistemin e-pasuria, përfshirë zhvlerësimin e pasurive si dhe regjistrimin e pasurive të mbetura. Po ashtu, procesi i inventarizimit duhet kryer me kohë, para përgatitjes së PFV-ve, si dhe raporti i inventarizimit duhet të përfshijë krahasimin e gjendjes fizike me atë në gjendjen e regjistrave. Nëse konstatohen diferenca ato duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.</p>	<p>Kemi konstatuar se edhe me tutje ky rekomandim është i pa pa zbatuar</p>	<p>I pa zbatuar</p>
5	<p>Të arkëtueshmet</p> <p>Çështja 5 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme</p>	<p>Kryetari duhet të siguroje forcimin e mekanizmave për inkasimin e të arkëtueshmeve duke i shfrytëzuar të gjitha masat në dispozicion, fillimisht duke i shfrytëzuar të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të komunës, më pas të shfrytëzoj edhe masat tjera ligjore.</p>	<p>Menaxhmenti ka marrë masa dhe janë në proces të përmirësimit të inkasimit</p>	<p>Në proces të zbatimit</p>
6	<p>Progresi në zbatimin e rekomandimeve</p> <p>Çështja 6 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit</p>	<p>Gjatë auditimit kemi vërejtur se rekomandimet janë në proces të zbatimit</p>	<p>Në proces të zbatimit</p>
7	<p>Sistemi i auditimit të brendshëm</p> <p>Çështja 7 - Mungesa e themelimit të NJAB-së</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj përmbushjen e kërkesës ligjore, respektivisht të rekrutoj një auditor të brendshëm. Nëse kjo kërkesë nuk mund të realizohet, atëherë shërbimi i auditimit të brendshëm, duhet të vazhdojë të kryhet nga Ministria e Financave, apo ndonjë subjekt tjetër publik. Shërbimi i auditimit, do të mbështeste menaxhmentin në vendimmarrje dhe eliminim të dobësive.</p>	<p>Kemi konstatuar se edhe me tutje ky rekomandim është i pa zbatuar</p>	<p>I pa zbatuar</p>

8	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.	Gjatë auditimit kemi vërejtur se rekomandimet janë në proces të zbatimit	Në proces të zbatimit
N	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
r				
1	Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	<p>Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për ti përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në shpалosjen e pasurive, regjistrimin e pasurive, dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të tyre</p> <p>Gjithashtu Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme..</p>		
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të bëjë një vlerësim gjithpërfshirës të shkaqeve të mosrealizimit të buxhetit në disa kategori të caktuara , si dhe të siguroj një planifikim të drejtë buxhetor krahas projekteve të synuara dhe monitorim të performances buxhetore në baza të rregullta me qëllim realizimit të buxhetit dhe evitimit të keqdeklarimeve.		
3	Te Hyrat	Kryetari duhet të siguroj dhe të marrë masa të duhura që mbrenda një periudhe sa më të shkurtër kohore të inkasoj të gjitha të arkëtushmet . Gjithashtu duhet të shqyrtohen të gjitha opsionet e mundëshme përfshirë edhe ato ligjore për të siguruar inkasimin e të hyrave të kësaj kategorie, si dhe të krijohet dhe mbahet një evidencë e qartë dhe e kompletuar me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që menaxhimi i të hyrave vetijake të jetë më efikas.		

4	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të siguroj se procesi i regjistrimit të pasurive në regjistrin e pasurive të Komunës duhet të realizohet duke u klasifikuar saktë në kodet ekonomike përkatëse dhe pas kryerjes së këtij procesi, gjendja e pasurive duhet inventarizuar. Pas inventarizimit gjendja e konstatuar duhet të krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme të identifikohen dhe më pas të pasqyrohen në regjistrat e pasurive.
5	Mungesa e mekanizmave për inkasimin e të arketueshmeve	Kryetari duhet të ndërmerr masa për të shqyrtuar shkaqet për dështim të inkasimeve të llogarive të arkëtueshme dhe të siguroj mekanizma efektiv për mbledhjen e tyre. Po ashtu, Kryetari duhet të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha obligimet e prapambetura dhe të inicoj proces të rivlerësimit të llogarive të arkëtueshme, ku të gjitha llogarite do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse dhe mundësive reale për inkasimin e tyre, e në raste të caktuara të bëhet provizionimi apo shlyerja e tyre në rast të kategorizimit si borgje të këqija
6	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të siguroj përmbushjen e kërkesës ligjore, respektivisht të rekrutoj një auditor të brendshëm. Nëse kjo kërkesë nuk mund të realizohet, atëherë shërbimi i auditimit të brendshëm, duhet të vazhdojë të kryhet nga Ministria e Financave, apo ndonjë subjekt tjetër publik. Shërbimi i auditimit, do të mbështeste menaxhmentin në vendimmarrje dhe eliminim të dobësive
7	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raporteve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit, procesi i regjistrimit dhe inventarizimit duhet të përfshinë gjithë pasurinë komunale. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmimi



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Elez Han

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit për vitin 2018 dhe për
implementimin e rekomandimeve

Për: "Univerzum Audit" Sh.p.k.

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Hanit të Elezit, për vitin 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Rufki Suma

Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit

Data: 21 Maj 2019, Hani i Elezit